



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 11      Datë 10. 04. 2017

““ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI  
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “MATEO&CO” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr.3719/4,datë 06.10.2016 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit uJOR të subjektit “**MATEO&CO** ” **sh.p.k.**,me propozim të A.B.U Drin-Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit UJOR Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e kërkesës së subjektit “**MATEO&CO** ” **sh.p.k** me administratore Znj.Elona NIKOLLAJ, për përdorim të burimit uJOR **Lumit Cemi i Selcës**, degë e Lumit Cemi i Bashkuar për prodhim energjie elektrike,në Selce, Nj.Adm. Kelmend; Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC MURASI do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes:      X – 43 83 859 ;      Y –47 06 768;      Z – +377 m  
Koordinatat e godinës së centrali:      X – 43 82 553;      Y –47 05 232;      Z - +293 m;  
Koordinatat e pikës së shkarkimit :      X – 43 82 553;      Y –47 05 232;      Z - +293 m;

Prurja mesatare vjetore e burimit uJOR:       $Q_{mes} = 3.07 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:       $Q_{llog} = 3.3 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Prurja ekologjike:       $Q_{ekol} = 0.5 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Prurja që shkarkohet:       $Q = 3.3 \text{ m}^3/\text{sek}$ .

2- Leja e përdorimit të burimit uJOR për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari

Martin PLLUMBI

Kryetar

Paulin RADOVANI

